

L I G J
Nr. 8929, datë 25.7.2002

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR KREDINË PËR MBËSHTETJEN E REDUKTIMIT TË VARFËRISË DHE TË DOKUMENTEVE TË LIDHURA ME TË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për kredinë për mbështetjen e reduktimit të varfërisë dhe të dokumenteve të lidhura me të”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3432, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Nr. i Kredisë 3670 ALB

MARRËVESHJA
E KREDISË SË ZHVILLIMIT
KREDIA PËR MBËSHTETJEN E REDUKTIMIT TË VARFËRISË MIDIS SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Datë 26 qershor 2002

Marrëveshja e datës 26 qershor 2002 midis Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata).

Ndërsa (A) Shoqata ka marrë një letër të datës 7 maj 2002 (Letra e Politikave të Zhvillimit) nga Huamarrësi që përshkruan programin e veprimeve, objektivat dhe politikat për të çrrënjësuar varfërinë nga vendi (Programi), duke deklaruar angazhimin e Huamarrësit për ekzekutimin e programit dhe duke kërkuar asistencë nga Shoqata për të mbështetur këtë program gjatë ekzekutimit të tij;

(B) Huamarrësi ka marrë masat dhe veprimet e përshkruara në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje kënaqshëm për Shoqatën; dhe

C) mbi bazën, ndër të tjera, të sa më sipër, Shoqata ka vendosur të mbështesë programin me një kredi me termat e mëposhtme.

Në bazë të sa më sipër, Palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kushtet e Përgjithshme; Përkufizimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës të datës 1 janar 1985 (siç janë ndryshuar deri më 6 tetor 1999) me modifikimet e mëposhtme (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

(a) Seksioni 2.01. paragrafi 12 modifikohet:
"Projekt" nënkupton programin referuar në hyrje të MKZH-së, në mbështetje të të cilit jepet Kredia.

(b) Seksioni 4.01. modifikohet:
"Përveç kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, tërheqjet nga Llogaria e Kredisë do të bëhen në monedhën e llogarisë të specifikuar në seksionin 2.02. të MKZH-së".

(c) Seksioni 5.01. modifikohet:
Huamarrësi do të ketë të drejtë të tërheqë shumat e kredisë nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e MKZH-së dhe këto Kushte të Përgjithshme".

(d) Fjalitë e fundit të seksionit 5.03 hiqet.

(e) Seksioni 9.06. ndryshohet si më poshtë:

"c) jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose datë tjetër që do të bihet dakord midis Palëve, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një raport të kënaqshëm për IDA-n për ekzekutimin e programit, referuar në hyrjen e Marrëveshjes, performancën e Huamarrësit dhe Shoqatës dhe detyrimet reciproke të tyre dhe përmbushjen e qëllimeve të Kredisë", dhe

(f) Seksioni 9.04. hiqet dhe seksionet 9.05, 9.06, 9.07, 9.08 rinumërohen respektivisht.

Seksioni 1.02. Vetëm në ato raste kur kërkohet ndryshe nga konteksti, afatet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara më poshtë:

(a) "Banka e Shqipërisë" nënkupton bankën qendrore të Huamarrësit.

(b) "Llogaria e Kredisë" nënkupton llogarinë e referuar në seksionin 2.02. (b) të kësaj Marrëveshjeje.

(c) "Vit fiskal" nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon në 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të çdo viti.

(d) "INSTAT" nënkupton Institutin e Statistikave të Huamarrësit.

(e) "GPRS" nënkupton strategjinë e rritjes dhe reduktimit të varfërisë të Huamarrësit.

(f) "Letra e Politikave të Zhvillimit" nënkupton letrën e referuar në hyrje pika A të Huamarrësit.

(g) "MTEF" nënkupton kuadrin afatmesëm të shpenzimeve buxhetore dhe jashtëbuxhetore, bashkë me detajet e projekteve më të mëdha të investimeve, të miratuar nga Huamarrësi.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i huajë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabartë me SDR 16,000,000.

Seksioni 2.02. (a) Sipas dispozitave të paragrafëve (b) dhe (c) të këtij seksioni, Huamarrësi do të tërheqë fondet nga llogaria e kredisë në mbështetje të programit.

(b) Huamarrësi do të hapë dhe do të mbajë në Bankën e Shqipërisë përpara depozitimit të kërkesës për disbursim një llogari me termat e kënaqshme për Shoqatën. Të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kredisë do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë e Depozitës.

(c) Huamarrësi merr përsipër që shuma e kredisë nuk do të përdoret për të financuar shpenzimet e përjashtuara në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse Shoqata do të ketë vendosur ndonjëherë që shumat e kredisë janë përdorur për këto qëllime, Huamarrësi:

(i) do të depozitojë në Llogarinë e Depozitës shumën e barabartë me këtë pagesë; (ii) ose rimbursojë Shoqatën dhe kjo shumë do të quhet anulim.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes do të jetë 30 qershor 2003 apo ndonjë datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një komision angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë, që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata më datë 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysmën e një për qind (1/2 1%) për vit.

(b) Komisioni i angazhimit do të rritet: (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj

Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen ose anulohen nga Huamarrësi shumat nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 qershor menjëherë përpara datës së interesit dhe me shumën tjetër, siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në seksionin 2.06. të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Komisioni i angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që kërkon Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02. të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të atij seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave të një përqindshit ($\frac{3}{4}$ e 1%) në vit mbi shumën principale të kredisë të tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06. Komisioni i angazhimit dhe ai i shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafëve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtëmujore të pagueshme në çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar nga 15 tetor, 2012 dhe duke përfunduar në 15 prill 2042. Çdo këst, duke përfshirë këstin e pagueshëm në 15 qershor 2020, do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) e kësaj shume principale.

(b) Kur: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit. Shoqata për të përcaktuar mundësinë për të përfitur nga burimet e Shoqatës; dhe (ii) Banka do t'a konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë të Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës së secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shumat principale e Kreditit; dhe

(B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysmëvjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje prej një minimumi prej pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa orë të gjitha rritjet në shumën e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që, në bazë të gjyqimit të Shoqatës, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve, siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3 Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron anagazhimin e tij për të zbatuar programin me kujdesin e duhur dhe të sigurojë që veprimet dhe politikat e miratuara në program kanë hyrë në fuqi.

(b) Huamarrësi dhe Shoqata do të kërkojnë nga secila Palë të këmbëjnë mendime për progresin e arritur në zbatimin e programit herë pas here.

(c) Përpara këmbimit të tillë të mendimeve, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës për rishikim dhe koment një raport mbi progresin e arritur në kryerjen e programit me detajet që do të kërkojë IDA.

(d) Pa u kufizuar në dispozitën e paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi do të këmbëjë mendime me Shoqatën për ndonjë veprim të propozuar për disbursimin e Kredisë që do të kishte efekt negativ në program, ose ndonjë veprim që mund të merret në kuadrin e tij.

Seksioni 3.02. Me kërkesë të Shoqatës, Huamarrësi:

a) do të auditojë llogarinë e depozitës në përputhje me parimet e pranuar të auditimit, me auditorë të pavarur, të pranuar nga Shoqata;

b) do t'i dorëzojë Shoqatës, jo më vonë se 4 muaj nga data e kërkesës së këtij auditi një kopje të raportit me detajet që ajo e kërkon;

c) do t'i dorëzojë Shoqatës informacion tjetër lidhur me Llogarinë e Depozitës, siç kërkohet nga Shoqata.

Neni 4

Ngjarje pezullimi

Seksioni 4.01. Për qëllime të seksionit 6.02. (1) të Kushteve të Përgjithshme, ngjarja e mëposhtme do të konsiderohet e tillë - është krijuar një situatë e tillë që e bën të pamundur që programi ose pjesë e konsiderueshme e tij të kryhet.

Neni 5

Përfundimi

Seksioni 5.01. Data e nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e seksionit 12.04. të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 6

Përfaqësimi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03. të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01. të Kushteve të Përgjithshme.

Huamarrësi:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

Shqipëri

Faks: 355 42 284 94

Për Shoqatën:

International Development Association

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabëll

INDEVAS

Washington, D.C.

Teleks:

248423 (MCI) ose

64145 (MCI)

Faks: (202) 477 - 6391

Në prani të dëshmitarëve, Palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

SHQIPËRIA Fatos Tarifa, Ambasador

ngaPërfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMChristian Poortman

ngaDrejtor për Shqipërinë

SKEDULI 1

Për qëllime të seksionit 2.02. (c) të kësaj Marrëveshje, Kredia nuk do të përdoret për të financuar shpenzimet e mëposhtme:

1. shpenzime në monedhë të Huamarrësit ose për mallra dhe shërbime të ofruara në territorin e Huamarrësit;

2. shpenzime për mallra e shërbime me kontratë me ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ose kombëtar ose agjenci përveç Bankës ose Shoqatës, të cilat kanë rënë dakord të financojnë ose të cilat Banka ose Shoqata kanë rënë dakord të financojnë me një kredi tjetër ose hua.

3. Shpenzime për mallra të grupeve dhe nëngrupeve të klasifikimit standard të tregtisë, publikuar nga Kombet e Bashkuara, ose grupe që më vonë do të caktohen nga Shoqata:

Pije alkoolike

Duhan i papërpunuar

Duhan i përpunuar

Materiale radioaktive

Perla dhe gurë të çmuar

Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre

Makineri të përpunimit të duhanit

Buzhuteri ari, platini, argjendi

Ar-jo-monetar.

4. Shpenzime militare ose para-militare;

5. Shpenzime për mallra të rrezikshme për ambientin, që do të thotë ato mallra përdorimi i të cilave konsiderohet nga ligjet e Huamarrësit dhe marrëveshjet ndërkombëtare i ndaluar;

6. Shpenzime (a) në territoret e ndonjë vendi që nuk është anëtar i Bankës ose mallra e shërbime të prokuruar në këto territore; ose (b) për llogari ndonjë personi ose njësie ose për ndonjë import ose mall, nëse kjo pagesë ndalohet me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

7. Shpenzime sipas ndonjë kontrate në lidhje me të cilën Shoqata ka vendosur se janë përdorur praktika korrupsioni ose mashtrimi gjatë prokurimit ose ekzekutimit të kontratës, kur Huamarrësi nuk ka marrë masa të kënaqshme për të rregulluar situatën.

SKEDULI 2

Programi i veprimeve për t'u marrë nga Huamarrësi

1. Huamarrësi ka mbajtur kuadër të mirë makroekonomik.

2. Huamarrësi ka zbatuar programin e reformave të sistemit të pensioneve publike.

3. Huamarrësi ka dorëzuar një plan të kënaqshëm për të forcuar monitorimin e vlerësimitin e GPRS-së dhe programet e lidhura me të në ministrinë e linjës.

4. Huamarrësi ka siguruar që INSTAT-i të pajiset me buxhet e staf për të kryer funksionet e tij.

5. Huamarrësi ka rritur buxhetin për shëndetin publik, operacionet, mirëmbajtjen dhe pagat në përputhje me MTEF.

6. Huamarrësi ka rritur alokimin buxhetor për vaksinimin e fëmijëve dhe grave.

7. Huamarrësi ka rritur buxhetin korent për sektorin e arsimit në 2002, sipas MTEF.

8. Grupi i punës në Ministrinë e Arsimit është krijuar me plan veprimi specifik për të zhvilluar funksionet e lidhura me: (a) analizën e politikave, planifikimin dhe monitorimin; (b) menaxhimin financiar; (c) menaxhimin e burimeve njerëzore; (d) menaxhimin e librave shkollore.

9. Huamarrësi: (a) ka miratuar një kryetar dhe anëtarë të autoritetit për miratimin e librave shkollore; (b) ka krijuar një njësi për menaxhimin e librave shkollore në Ministrinë e Arsimit.

10. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave të Huamarrësit është dërguar në Parlament.

11. Ka hyrë në fuqi vendimi për rritjen e pagave të shërbimit civil.

12. Huamarrësi ka dorëzuar raportin e vlerësimit që vërteton se buxheti 2002 është në

përputhje me MTEF-në.

13. Huamarrësi ka kërkuar që: (a) të gjithë zyrat e thesarit të dërgojnë pagesat ditore në thesarin qendror; (b) thesari qendror të rakordojë mbi bazë ditore pagesat bazuar në informacionin e BSH-së; (c) zyrat e taksave në rrethe të rakordojnë faturat e taksave me shumat e transmetuara nga Banka e Shqipërisë në bazë ditore.

14. Huamarrësi ka përgatitur një projektligj të kënaqshëm për auditim të brendshëm.

15. Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar një set të praktikave të prokurimit për 2001.

16. Huamarrësi ka përgatitur një plan të kënaqshëm për transferimin e pasurive publike pushtetit lokal.

17. Huamarrësi ka përfunduar një studim për prezantimin e taksës mbi tokën si taksë lokale.